



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ndryshimet klimatike”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Elona Gjebrea, Anduel Xhindi dhe Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Luan Harusha, Luan Duzha, Elena Xhina, Paulin Sterkaj, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Pëllumb Abeshi - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Enerieta Tarelli - Përfaqësuese nga Drejtoria Juridike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Çelim mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, meqenëse kuorumi i mbledhjes na e lejon fillimin e saj.

Sot në rendin e ditës së mbledhjes kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ndryshimet klimatike”. Sqaroj kolegët se ky projektligj është vetëm për dhënie mendimi nga ana e komisionit tonë, pra nuk jemi komision përgjegjës, por në Konferencën e Kryetarëve kemi kërkuar që ky projektligj të bëhet pjesë e axhendës së mbledhjeve të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, për faktin se ndryshimet klimatike janë një ndër çështjet kryesore, që diskutohet sot për sa i takon çështjes së sigurisë. Kështu që do të ishte rasti më i mirë që deputetët e këtij komisioni të merrnin informacion më të hollësishëm në lidhje me përmbajtjen e këtij ligji, lidhur me faktin se sa përafrohet ky projektligj me legjislacionin e ngjashëm ndërkombëtar. Shikoj që është një ligj për ndryshimet klimatike, që bëhet rishtazi, kështu që shpresoj të kemi një ligj në lartësinë e duhur.

Dihet që para 2 vjetësh ka pasur një akord mbarëkombëtar në Paris, një angazhim i të gjitha shteteve për të kontribuar në çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike. Edhe Shqipëria ka qenë pjesëmarrëse në konferencën kombëtare. Besoj se është rasti që qeveria të shprehë marrjen përsipër të një përgjegjësie kaq të rëndësishme.

Për të prezantuar këtë projekt do të kemi zëvendësministren e Turizmit dhe Mjedisit, zonjën Orneta Çuçi, zotin Pëllumb Abeshi, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mjedisit dhe zonjën Enerieta Tarelli, përfaqësuese nga Drejtoria Juridike e kësaj ministrie. Mirë se erdhët në Komisionin e Sigurisë!

Relatore për këtë projektligji është zonja Elona Gjebrea.

Dua t’i jap fjalën zonjës zëvendësministre, për të na bërë një prezantim të përmbledhur të projektligjit, të risive që ai sjell, të detyrimeve dhe të drejtave. Më pas fjalën e ka zonja Gjebrea.

Fjala është për ju, zonja Çuçi.

Orneta Çuçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Përsëritje të gjithëve!

Sot jemi duke kaluar një nga ligjet më të rëndësishme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë në këtë 2-vjeçar, ligjin “Për ndryshimet klimatike”. Ndryshimet klimatike në vendet e vogla, si vendi ynë, perceptohen si ndryshime që ndodhin shumë larg,

pra ndodhin aty dhe ngelen aty, për shembull, në Arktik. Nga ana tjetër duhet të specifikojmë që ndryshime të tilla nuk ndodhin vetëm atje dhe ngelen atje, sepse ne konsiderohemi si një nga 50 vendet e para në listën e 198 vendeve që aderojnë sot në OKB, që impaktohen drejtpërdrejt nga ndryshimet klimaterike. Vërtet nuk impaktojmë si vend, sepse emetimi ynë për gazet e efektit serrë nuk është në nivele të larta, por jemi një ndër vendet më të impaktuara nga këto. Këtë mund ta prekim të gjithë përmes erozionit të madh që ka ndodhur vitet e fundit në vendin tonë, përmbytjeve e të tjera.

Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë të gjithë bazën ligjore, të cilën nuk e kemi aktualisht për integrimin e politikave dhe për masat efektive që mundësojnë plotësimin e detyrimeve që keni ndaj konventës për ndryshimet klimatike dhe arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe ruajtjes së rezervuarve të vendit.

Të krijojmë përshtatje ndaj ndryshimeve klimave në nivel kombëtar ose lokal, evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime, duke përdorur metodologji sipas modeleve të konventës për ndryshimet klimatike dhe sipas ligjeve të Bashkimit Europian.

Ky ligj përbëhet nga 6 krerë, 7 seksione, 47 nene dhe 9 anekse. Duhet të specifikohet që flitet për zbutjen dhe përshtatjen, e cila është e ndarë në 7 seksione; për autoritetet kompetente dhe në dy nene të veçanta i jepet përgjegjësia për ta zbatuar këtë ligj, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Thelbi i gjithë kësaj është se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si pika fokale për konventën ndërkombëtare të ndryshimeve klimatike, është institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit të monitorimit, të raportimit dhe verifikimin e procesit të komunikimit kombëtar dhe raporteve azhornuese 2-vjeçare.

Dua të specifikoj se Shqipëria që nga viti 2003 ka përgatitur 3 komunikime kombëtare dhe është në fazën e përgatitjes së komunikimit të 4 kombëtar për emetimin e gazeve në ajër. Në fakt, të tria komunikimet kombëtare pararendëse, që nga viti 2003 deri në vitin 2018, kanë qenë komunikime, të cilat nuk janë reflektuar thellësisht në kuadrin e legjislativ të vendit tonë. Pikërisht, sot gjendet rasti që të gjitha këto rezultate dhe indikacione që kanë treguar komunikimet kombëtare në vend, tashmë të gjejnë bazën ligjore për t'u zbatuar në Shqipëri.

Pa u futur në detaje teknike të gazrave që emetohen në Shqipëri dhe se çfarë duhet që ky ligj të parandalojë, dua të specifikoj faktin se për herë të parë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është ndërmarrë iniciativa që përmes këtyre projekteve të mëdha, të mbështetura nga *Green Climate Fund* dhe *Global Environment Facilities* përmes organizmave si *UNEP-i* dhe *UNDP-ja*. Në kuadër të Paktit me Universitetin, jemi duke bashkëpunuar me Universitetin

Politeknik të Tiranës për të themeluar për herë të parë në vendin tonë masterin e parë shkencor për ndryshimet klimatike.

Sot ekspertiza në vend është jo e mjaftueshme për ndryshimet klimatike, është një ekspertizë e ndarë dhe kahëzuar vetëm për specialitete të ndryshme. Edhe pse sot për sot në të gjithë botën ndryshimet klimatike janë kryefjala e fjalëve të çdo qeverisjeje dhe të çdo politike, e cila ndërmerret në OKB, por edhe në Bashkimin e Europian, sot në Shqipëri nuk gjejmë specialistë të mirëfilltë, të cilët t'i njohin ndryshimet klimatike me themel. Në këtë kuadër, jemi duke themeluar të parin master shkencor, i cili do të sjellë në vazhdim specialistë të mirëfilltë për ndryshimet klimatike për ta bërë edhe ligjin, që do të zbatohen në të ardhmen, të qëndrueshëm në nivelin e njohurive dhe në nivelin e kapaciteteve që ka vendi.

Në aneksin e parë të këtij projektligj specifikohen gazet me efekt serrë, të cilat kryesisht janë dyoksidi i karbonit dhe oksidet e azotit.

Në aneksin e dytë janë gazet me efekt serrë, që u nënshtrohen kërkesave të këtij ligji. Më pas vazhdojmë me listën e aktivitetit të aviacionit, që përjashtohet nga ky ligj; lista joshteruese e çështjeve, që duhen trajtuar në dokument; përcaktimi i kontributit kombëtar të pikësynuar; lista joshteruese e çështjeve, që duhen trajtuar në dokumentin AMA; lista joshteruese për planin kombëtar për përshtatje (implementimin e të cilit e fillojmë fatmirësisht për herë të parë në vendin tonë në datën 1 dhjetor me *UNDP-në*; lista joshteruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin e komunikimit kombëtar dhe listën joshteruese të çështjeve, që duhen trajtuar në dokumente të tjera.

Ky projektligj është hartuar duke transpozuar konventën për ndryshimet klimatike, por, nga ana tjetër, i jemi përmbajtur edhe konferencës së palëve dhe *acquis-ë* për ndryshimet klimatike dhe jemi munduar të jemi sa më afër transpozimit të legjislacionit të Bashkimit Europian. Ne kemi statusin si vend jo-aneks 1 në konventën klimatike dhe, kështu, kërkesat e konventës dhe vendimet e konferencave të palëve janë të vendosura në këtë ligj sipas këtij statusi që ne përformojmë në OKB.

Ndryshimet klimatike të vendosura për situatën aktuale në Republikën e Shqipërisë, si një vend kandidat, jemi munduar t'i përafrojmë maksimalisht, por duke pasur gjithmonë parasysh faktin e implementimit të këtij ligji në të ardhmen. Nuk i kemi marrë *mot a mot* të gjitha direktivat e Bashkimit Europian për ndryshimet klimatike, por jemi munduar t'i përshtatim dhe t'i sjellim në realitetin shqiptar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çuçi!

Besoj se kjo ishte përmbledhja e përmbajtjes së projektligjit.

Zonja Gjebrea, fjala është për ju.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre dhe ju, të nderuar përfaqësues, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit!

Në fakt, projektligji që vjen sot këtu për sa u përket ndryshimeve klimatike, është shumë i rëndësishëm, i domosdoshëm për të gjitha arsyet që u përmendën edhe në fjalën e zëvendësministres, qoftë fakti që kemi ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, qoftë fakti që kemi të ratifikuar edhe protokollin e Kajros.

Nga ana tjetër, Shqipëria është në një situatë komplekse për sa i përket harmonizimit të legjislacionit të BE-së për klimën, pasi ka një vështirësi që duhet kaluar, fakti që Shqipëria ka ratifikuar konventën, por, nga ana tjetër, ne kemi të gjithë dëshirën dhe po punojnë për t'u aderuar në BE bëjnë që të jemi më agresiv në përputhjen e legjislacionit për sa u përket ndryshimeve klimatike. Në fakt, ashtu siç thuhet edhe në relacion, është në fazën e parë të punës.

Nga ana tjetër, të gjithë ne jemi të ndjeshëm për sa u përket ndryshimeve klimatike. Patjetër, Shqipëria nuk mund të ketë një imunitet në lidhje me këtë, kështu që na duhet një legjislacion si ky që vjen sot, por edhe të tjerët që do të pasojnë do të ndihmojnë që të kemi mundësi të parandalojmë ose t'i minimizojmë efektet e ndryshimeve klimatike.

Në fakt, jam edhe anëtare e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe jam zgjedhur raportere në komitetin e dytë që ka të bëjë me çështje të klimës dhe me çështje të shkencës dhe teknologjisë. Pa dyshim, do të ishte mirë që të keni në konsideratë rezolutën, e cila është miratuar verën që kaloi nga sesioni vjetor i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe të gjitha vendet anëtare të OSBE-së, duhet të marrin shumë masa dhe kanë detyrime për të përmbushur në fushën e ndryshimeve klimatike.

Në fakt, këto shqetësime, shikoj se janë të përmendura dhe të reflektuara në këtë ligj që vjen sot. Sigurisht, ne kemi nevojë që të përmirësojmë shumë gjëra, por, nga ana tjetër, duhet të kemi kujdes që të kemi një harmonizim të legjislacionit për substancat hozonholluese, gazet serrë të fluorinuara, tregtinë e shkarkimit të gazeve serrë dhe ruajtjen gjeologjike të CO2it.

Nga ana tjetër, besoj se ju keni marrë në konsideratë të gjitha ato që ka thënë progresraporti i BE-së për Shqipërinë. Në fakt, në relacionin tuaj përmendën vitet 2013 dhe 2015 dhe nuk ka një kronologji. Do të ishte mirë që të kishte një renditje më të mirë, se çfarë kanë thënë konkretisht. Nuk është detyrim, por, meqenëse e keni përmendur, ta vazhdoni deri në fund, sepse jeni me progresraportin e vitit 2013, ndërkohë ne kemi progresraportin e vitit

2018. Gjithsesi, mbase nuk ka pasur gjëra të reja, nuk jam në gjendje ta them këtë, por do të ishte mirë që të ishte pak e përmirësuar.

Projektligji është hartuar duke përdorur terminologjinë e konventës, të vendimeve të konferencave të palëve dhe të *acquis*-ë për ndryshimet klimatike. Sikurse e thashë, përmbajtja në fakt ka parasysh edhe statusin e Shqipërisë, kërkesat e konventës, statusin e vendit jo-aneks 1 në konventë, që ju e përmendët, ashtu sikurse edhe të gjitha përpjekjet dhe situatën aktuale të vendit tonë si një vend kandidat, që po punon për të filluar negociatat.

Sigurisht, ne kërkojmë që të kemi një vend, sikurse thashë, të jetë agresiv dhe të ofrojë një legjislacion të fortë, që do ta ndihmojë në këtë përpjekje. Shqipëria ka ende probleme me ndotjen klimatike dhe me të gjitha problemet, që përmendëm. Shpresoj që ministria do të ketë mundësi që të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore, që të jetë sa më shtrënguese për sa u përket të gjitha efekteve që elemente të caktuara shkaktajnë dëm, që në fund të ditës është në dëm të shëndetit të njerëzve.

Faleminderit për të gjithë punën e bërë!

Pashë që ky është një projektligj i sjellë nga një proces i gjatë konsultimi me shumë ministri të linjës dhe shpresoj që të keni një bashkëpunim në vijim, pasi puna për çështje të klimës kërkon një bashkërendim dhe, në mënyrë absolute, nuk mund të bëhet asnjëherë nga një institucion i vetëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Mendoj se sjellja e projektligjit në këtë moment përkon edhe me një fakt tjetër po aq të rëndësishëm: presidenca e Bashkimit European është marrë nga Finlanda dhe për 6 muajt e ardhshme do të jetë e kryesuar nga Finlanda, e cila si objekt kryesor në veprimtarinë dhe punën e saj gjatë drejtimit të Bashkimit European do të ketë ndryshimet klimaterike. Ju e thatë edhe pak në fjalën tuaj që duket sikur vetëm Arktiku preket nga ndryshimet klimatike dhe vetëm ato vende afër Arktikut kanë përjetuar verën më të nxehtë ndonjëherë, por, në fakt, ndonëse nuk jemi direktë specialistë të fushës, arrijmë të kuptojmë që pësues të ndryshimeve klimatike jemi edhe ne. Fakti që Shqipëria renditet si vendi i parë në Europë për emergjencat civile dhe i 40-ti në botë po për të njëjtën çështje (ne sapo e kemi miratuar ligjin “Për emergjencat civile”), duhet të na ndërgjegjësojë se sa e rëndësishme është që ne t’u paraprijmë me mekanizma ligjorë, me instrumente ligjorë, siç është ligji për ndryshimet klimatike, në mënyrë që të zvogëlojë ato efekte, që janë të dëmshme në jetën, në shëndetin e njerëzve, në ekonomi e në të tjera aspekte të rëndësishme të jetës publike.

Dua t’ua kaloj fjalën kolegëve, nëse kanë pyetje për projektligjin.

Zonja Gjebrea ka diçka për të shtuar.

Më pas zonja Dhima dhe zoti Murrizi.

Elona Gjebrea – Në fakt, në lidhje me atë që ju përmendët për pjesën e Arktikut, në qoftë se mund ta ndaj këtë eksperiencë për 2 minuta, si pjesë e komitetit kam qenë edhe në një vizitë studimore në Arktik. Në fakt, është një shprehje e famshme (nuk po futem në detaje, sepse mund të jenë pjesë e një bisede jashtë kamerave), që përmendet shpesh nga OSB-ja: “What happens in the Arctic doesn’t stay in the Arctic”. Kështu që nuk është e thënë që është Arktiku i prekur. Pa dyshim, të gjitha ndryshimet sjellin efekte edhe te ne.

Faleminderit!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre, për prezantimin e projektligjit!

Kam dy pyetje.

Pyetja e parë: A ka kosto vendi ynë si rezultat i këtij projektligji?

Pse ju, si ministri, e keni ndërmarrë këtë iniciativë?

Pyetja tjetër: Për vendosjen e gjobave për kundërvajtjet administrative keni pasur parasysh ndonjë referencë të vendeve të tjera apo jeni bazuar në ligjin kuadër për gjobat në mjedis?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Po, zonja Çuçi.

Ornela Çuçi - Faleminderit, zonja Dhima!

Në fakt, e kemi marrë këtë iniciativë, sepse duhet të jemi në koherencë me të gjitha vendet e Bashkimit European, por jo vetëm. Ju e thatë se sa të rëndësishme janë ndryshimet klimatike. Ne nuk kemi asnjë bazë ligjore deri tani. Ato janë vetëm të përmendura spontanisht në disa prej projekteve që kemi ose në disa prej ligjeve që bëjmë dhe ndryshimet klimatike janë thjesht të përmendura tangjent. Shqipëria duhet të futet njëherë e mirë në këtë kuadër dhe të formësojë kuadrin e bazës ligjore për ndryshimet klimatike. Prandaj e morëm këtë iniciativë. Kjo duhet të ishte bërë me kohë, por ne duhet ta sillnim pak “me këmbë në tokë” ligjin. Prandaj sot ky ligj vjen këtu, edhe pse punohet prej 3 vjetësh në ministrinë tonë për këtë dhe jo vetëm në ministrinë tonë. Ka qenë një projekt i Bashkimit European, i cili na ka ndihmuar me ekspertizë vendase dhe të huaj për shkrimin dhe sjelljen e këtij ligji në realitetin shqiptar.

Më pyetët nëse ka një sistem gjobash dhe ku jemi referuar ne për kundërvajtjen. Më ndihmoni, se ndoshta...

Antoneta Dhima – A ka kosto...?

Ornela Çuçi – Ministria është pika fokale kombëtare e konventës. Institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit të këtij ligji është ministria.

Po ju përmend, për shembull, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, e cila ka pjesën e energjetikës dhe i ka të përshkruara në PBA të gjitha ndryshimet që duhet të ndodhin në këtë ligj.

Gjithashtu, për 3 vjet i kemi dhënë kohë vetes për ta riparë ligjin, në qoftë se do të ketë ndryshime të tjera. Aktualisht, ajo çfarë është përshkruar në ligj ka qenë e reflektuar në PBA-të e të gjitha ministrive, që janë përgjegjëse për implementimin e pjesëve të ndryshme të ligjit, ndërkohë që ministria ngarkohet me koordinimin e të gjitha pjesëve që mund të reflektohen.

Më pyetët për gjobat. Është një nen i veçantë, që i kushtohet kundërvajtjeve, që kanë të bëjnë me mosrespektimin e detyrimeve raportuese të operatorëve të kategorive të ndryshme sipas kërkesave të këtij ligji, në analogji dhe sintoni të plotë me kërkesat e ligjit për lejet e mjedisit, i cili tregon se gjobat në vendin tonë janë ndërmarrë me qëllim parandalimin e ndotjes mjedisore dhe janë relativisht të larta nga gjobat e tjera, që merren nga shteti shqiptar për frenimin e ndotjes mjedisore. Të gjitha ligjet e mjedisit sot për sot në Shqipëri janë të transpozuar duke u bazuar në direktivat e Bashkimit Europian.

Nëse mund ta specifikoj, me këtë ligj ne kemi ulur masën e kamatës nga 10%, që e përshkruan ligji bazë për lejet e mjedisit, në 2 % në ligjin për ndryshimet klimatike.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çuçi!

Zoti Murrizi, fjala është për ju.

Myslim Murrizi – Zonja zëvendësministre, doja të dija nëse zbatimi i këtij ligji do të ndiqet nga Ministria e Mjedisit apo do të ketë një agjenci ekstra për ta ndjekur këtë ligj?

Nëse do të ndiqet nga Ministria e Mjedisit, a keni ju një drejtor që merret konkretisht me këtë punë? Nëse do të krijohet një agjenci ekstra, nga kush do të varet?

Për pjesën e ligjit, për të thënë të drejtën, shqyrr që mbas 2000 vjetësh njerëzit po vijnë vërdallë të frenojnë natyrën (Zotin, nuk besoj)...! Ligje bëjmë sa të duash, por e di vetë Zoti se çfarë do t'i bëjë klimës! Kjo është kosto për gjithë botën.

Si thua ti, Ermonela?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bësh ligj kundër Zotit...!

Ermonela Felaj – Ne sot do të ndajmë punët e njerëzve, pastaj se çfarë ka ndarë Zoti për njerëzit...

Zonja Çuçi, një përgjigje për pyetjen e zotit Murrizi.

Faleminderit!

Ornela Çuçi – Bazuar në ligj, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është koordinatori i të gjitha institucioneve që duhet të ngarkohen me zbatimin e ligjit. Institucionet për zbatimin e ligjit janë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Departamenti i Emergjencave Civile, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, INSTAT-i dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Ndërkohë, për pyetjen nëse kemi një drejtori të veçantë që merret me ndryshimet klimatike apo nëse kemi ndër mend të bëjmë një agjenci, nuk ka një drejtori që merret me ndryshimet klimatike në ministrinë tonë. Është një drejtori që merret me fusha të ndryshme. Ka specialistë për efektet serrë, për emetimin e gazeve, ndotjen e ujit, ndotjen e tokës, ashtu siç ka edhe një specialist të veçantë për ndryshimet klimatike.

Nga ana tjetër, ne jemi duke e ndryshuar gjithë strukturën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, që është një ndër strukturat bazë të zbatimit të këtij ligji, po të marrim në konsideratë krijimin e kapaciteteve të reja brenda kësaj agjencie, veçanërisht, për implementimin e këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Ministria e Mjedisit është ministria përgjegjëse, pastaj detyrimet i merr çdo institucion qendror. Në krye të të gjithë veprimit për mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, sigurisht, do të jetë kjo ministri. Do ta ketë të përshkruar edhe në përgjegjësitë e saj.

A ka pyetje nga kolegë të tjerë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Do t'ia jap fjalën zotit Maliqi.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zonja kryetare dhe ju, drejtues të Ministrisë së Mjedisit!

Faktikisht, është hera e parë që nuk do të bëj pyetje, por një vlerësim për kalimin e këtij projektligji, për rëndësinë që i jepet edhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare dhe për efektin psikologjik e mediatik që ka te qytetarët, shoqëritë apo individët, sidomos në vendet ku ka gurore, prodhime naftë dhe gazi, që dëmtojnë mjedisin. Ky projektligj dhe mediatizimi i tij kanë efekt parandalues. Kështu që, me këtë rast, edhe si opozitë, them se duhet bërë më shumë, megjithëse e vlerësoj punën e Ministrisë së Mjedisit, angazhimin që ka marrë për ambientin, pastrimin e të gjitha me radhë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Zoti Maliqi, faleminderit për komentin!

Ka pyetje nga kolegët?

Nëse mundem, dua të bëj një pyetje për zonjën Çuçi dhe zotin Abeshi. Kam parasysh këtu që zoti Abeshi ka një përvojë më të gjatë në Ministrinë e Mjedisit.

Ju keni parashikuar që ligji të hyjë në fuqi 6 muaj nga botimi në Fletoren Zyrtare, ndërkohë, aktet nënligjore, që bëjnë të mundur zbatimin e plotë dhe efektiv të tij, të bëhen në harkun kohor të 4 vjetëve.

Desha të di, se pari, si justifikohet kjo kohë kaq e gjatë që keni marrë? Dakord, 6 muaj mund të bëjë sens për të njohur ligjin, por 4 vjet për përgatitjen e akteve nënligjore duket një kohë e gjatë. Sidoqoftë, do të vlente një shpjegim.

Nga ana tjetër (këtë përgjigje e dua nga zoti Abeshi), çfarë pritet të sjellë për qytetarët dhe institucionet miratimi i këtij projektligji në kohë të shpejtë? Pra, çfarë ndryshon ky projektligj menjëherë ose 6 muaj mbas hyrjes së tij në fuqi nga botimi në Fletoren Zyrtare?

Pëllumb Abeshi – Është planifikuar që koha e plotë e hartimit të akteve nënligjore të jetë 4-5 vjet, por hyrja në fuqi e ligjit është e menjëhershme.

Më e rëndësishmja dhe produkt i këtij ligji është ngritja e një sistemi kombëtar të monitorimit të gazeve me efekt serrë, që, aktualisht, ne nuk e kemi. Me ngritjen e këtij sistemi detyrim i parë është raportimi qoftë në konventë, qoftë në Bashkimin Europian, që mbështet me projekte dhe financime qeverinë shqiptare. Ngritja e këtij sistemi, natyrisht, kërkon një identifikim ritmik. Projekti i programit të Bashkimit Europian IPA, që e përmendi edhe zonja zëvendësministre, na ka mbështetur dhe ka bërë një studim të përgjithshëm fizibiliteti, por ama duhet një punë konkrete për ngritjen e këtij sistemi. Kjo ngarkon me detyrim të gjitha ministrinë përgjegjëse, sipas fushave të tyre, që janë edhe burim i emetimit të gazeve serrë, siç është transporti, industria, bujqësia dhe fusha të tjera, që emetojnë gazet me efekt serrë dhe secila, sipas tyre, duhet të bëhet pjesë e sistemit kombëtar. Kjo ka një kosto, sepse duhen ngritur institucionet, laboratorët, sistemi i raportimeve e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për momentin, kjo kosto nuk është llogaritur, sepse është lënë të llogaritet dhe të implementohet me PBA-në. Është llogaritur kostoja për hartimin e akteve, identifikimin e subjekteve dhe marrjen e masave për trajnime, rritje të kapaciteteve, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aktualisht, sistemin e monitorimit permanent të gazeve me efekt serrë e kanë vendet e zhvilluara dhe vendet e Bashkimit Europian, kurse vendet si Shqipëria dhe vende të tjera të rajonit, si Serbia dhe Mali i Zi, nuk e kanë krijuar akoma këtë sistem, për arsye se ne nuk jemi

vende që kontribuojmë në rritjen e gazeve serrë, sepse ato janë vende të zhvilluara industriale. Megjithatë, duke qenë pjesë e kësaj marrëveshjeje dhe e këtij sistemi ndërkombëtar, siç është konventa e ndryshimeve klimatike, protokolli Kioto, marrëveshja e Parisit e të tjera, vendet duhet ta ngrenë këtë sistem.

Aktualisht, ne kemi bërë vlerësimin, edhe nëpërmjet projektit që u përmend më parë, nga PNUD-i, që na ka hartuar komunikimin e parë të dytë dhe të tretë dhe jemi në proces për të katërtin. Këto projekte kanë asistuar në vendin tonë për të raportuar dhe kanë përlogaritur shkarkimet që kemi bërë ne që nga '90-ta e deri tani. Me ngritjen e sistemit ne duhet të raportojmë çdo vit, siç raportojmë për gjendjen e mjedisit, që do të jetë pjesë edhe e sistemit kombëtar të monitorimit të mjedisit.

Mendoj se kjo është arsyeja e shtyrjes në afatin kohor, sepse edhe laboratorët që do të monitorojnë duhet të akreditohen dhe akreditimi ka një afat kohor.

Ornela Çuçi – Për ta përmbledhur me një fjali: për implementimin e ligjeve kaq të rëndësime, të cilat kanë nevojë edhe për implementimin në infrastrukturë, sigurisht që u është dhënë një kohë 4-vjeçare të gjithë operatorëve, në mënyrë që të përshtatin gjithë infrastrukturën e tyre për t'u bazuar në kushtet e ligjit. Për të matur nivelin e gazeve të ndryshme, për shembull, në mënyrë permanente kemi nevojë të kemi gjithë infrastrukturën, jo vetëm me laboratorë, por edhe me matës nëpër qytete e gjithkund tjetër. Ka nevojë për një infrastrukturë pas këtij ligji. Kjo është e përshkruar në PBA.

Nga ana tjetër, kjo ka nevojë për kohë për t'u implementuar në terren. Prandaj i është dhënë një kohë kaq e gjatë, që paralelisht me aktet të vazhdojë edhe implementimi në terren i këtij ligji.

Çfarë efekti të menjëhershëm do të sjellë kjo? Aktualisht, ne aderojmë në shumë fonde të klimës. Ne aderojmë në shumë fonde të OKB-së, që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, por kemi marrë shumë pak nga këto fonde, për shkak të legjislacionit dhe kuadrit ligjor që kemi përgatitur. Pra, ky është hapi i parë, që ne të jemi komodë për të aplikuar në projekte të mëdha. Këto fonde nuk janë pak. Vendet e rajonit marrin shumë herë më tepër se ne nga këto fonde për të implementuar gjithë përshtatjen e laboratorëve dhe infrastrukturën e nevojshme për çështjet e ndryshimeve klimatike.

Ermonela Felaj - Nëse mundem (u kërkoj ndjesë kolegëve, sepse nuk dua ta rimarr fjalën, por dua të qëndrojmë edhe pakëz këtu) për informacion do të doja të dija, aktualisht, si e matim ne ndotjen e ujit, ajrit, tokës dhe nëntokës?

Dua të sjell në vëmendjen tuaj që ne sapo kemi kaluar disa ndryshime në Kodin Penal, posaçërisht, në kapitullin që lidhet me mjedisin. Më herët kemi pasur rastin ta diskutojmë edhe

me aktorë të ndryshëm të fushës. Të paktën mbrojtja e mjedisit ka qenë shumë e mirëpritur, por kuptohet që në përmbajtje gjëja është shumë teknike. Kështu që do të na vlente një shpjegim i natyrës më praktike, jo thjesht neve, por edhe publikut që na ndjek ose do të na ndjekë gjatë seancës së miratimit të këtij projektligji. Të na informoni më tepër për këtë pjesë, se çfarë disponon Shqipëria, aktualisht. E kuptuam që Shqipëria ka nevojë të krijojë aksesin në fondet e Bashkimit Europian, në mënyrë që të implementojë projekte, që lidhen me mbrojtjen nga ndryshimet klimatike.

Vetëm një sqarim për këtë pjesë dhe pastaj do t'ia kaloj fjalën zotit Murrizi. Zoti Vorpsi u tërhoq.

Ornela Çuçi – Aktualisht, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit ne kemi laborator të mirëfilltë, që bën analizat e shumë parametrave për ndotjen e ujit. Për herë të parë në dy vjetët e fundit ne e kemi akredituar ndërkombëtarisht këtë laborator për të gjithë parametrat inorganik të ujit dhe jemi duke punuar për parametrat organikë dhe ato mikrobiologjikë.

Nga ana tjetër, kemi ndihmuar, përmes projekteve që kanë partneritet me ministrinë tonë, në mënyrë të tillë që laboratorët, që aktualisht gjenden në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës, të akreditohen për parametra, të cilat ne nuk i kemi aktualisht në ministrinë tonë, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të akredituar.

Janë duke punuar në terren në të gjithë Shqipërinë disa matës për cilësinë e ajrit, si në Elbasan, Tiranë, Durrës, pra, qytetet kryesore. Mirëmbajtja e tyre është një nga kostot më të mëdha, që, sot për sot, zë në buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Kjo duhet specifikuar patjetër, sepse mjedisi kushton.

Për sa u përket parametrave të cilësisë së tokës, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit janë duke u matur disa prej parametrave të cilësisë së tokës, por gjithmonë në bashkëpunim me laboratorë të tjerë të akredituar. Për shembull, për metalet e rënda është laboratori i Universitetit Bujqësor të Tiranës ai që bën matje specifike dhe është i akredituar për këtë çështje. Në Shqipëri ka disa laboratorë që bëjnë matje të ndryshme dhe ne mundohemi të koordinohemi përmes instancave shtetërore, por ka pasur edhe raste, për shembull, për faktin nëse qeset kanë qenë të biodegradueshme apo jo, që e kemi kontraktuar këtë shërbim, sepse nuk kemi pasur, brenda akreditimit të njësive tona, laboratorë të akredituar për këtë gjë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Pyetja ime është gati e njëjtë me pyetjen e kryetares, për 4-vjeçarin që është dashur për të bërë ligjin. Ky është ligj ekstra shqiptar apo kopje e ligjeve që ka BE-ja apo më gjerë, vendet e Perëndimit? Pra, është përshtatur për kushtet që ka vendi ynë dhe

prandaj janë dashur 4 vjet? Pra, në këto katër vjet keni bërë ndonjë studim enkas apo eksperiment për të marrë modelin e BE-së apo të vendeve Perëndimore? Çfarë keni ndryshuar në ligjin që na sillni për miratim nga ligji bazë që ka BE-ja për klimën?

Ju thatë që keni pajisje që matin ndotjen e ajrit. Në sa qytete ka pajisje që matin ndotjen e ajrit?

Meqenëse thatë që ka kosto të mëdha për t'i mirëmbajtur, sa kushton një nga ato pajisje që ju thatë se janë vendosur në katër apo pesë qytete?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhjetë nga gjashtëdhjetë e një. Po i shtoj tre për hatrin tim, sepse nuk bëhet kiameti.

Sa është vlera e njëres prej atyre pajisjeve. Për ndotjen e ujit është ndërtuar një laborator i mirë pranë ... Është vetëm në Tiranë apo ...? Domethënë, e gjithë Shqipëria, kur do të masë ujin, duhet ta bjerë në Tiranë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I akredituar do të thotë që ka njëfarë certifikimi dhe është i besueshëm. Akreditimi është besueshmëri. Sepse pastaj është si Universiteti "Kristal". Ashtu mund të ketë kushdo. Kanë të gjithë ata që shesin ujë me bot në Lushnjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka problem. Për këtë po pyesja më shumë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zonja Çuçi dhe zoti Abeshi.

Pëllumb Abeshi – Iniciativa e ministrisë është që të hartohet për herë të parë ligji "Për ndryshimet klimatike". Çështjet e ndryshimeve klimatike deri tani kanë qenë të integruara edhe në ligjet e tjera që ne kemi pasur; ligji për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e biodiversitetit, ligjet për natyrën dhe shumë elemente të tjera, kurse iniciativa e marrë tani është që të kemi një ligj vetëm për ndryshimet klimatike, duke integruar detyrimet që Shqipëria ka si palë në Konventën e Ndryshimeve Klimatike, sepse jemi palë prej disa vitesh. Duke qenë palë kemi një sërë detyrimesh, që padyshim janë integruar në këtë ligj.

Ndër detyrimet kryesore që na del tani është të ngremë sistemin kombëtar të monitorimit dhe të raportimit të gazrave me efekt serrë. Ne kemi një sistem kombëtar të monitorimit të mjedisit, të disa treguesve, por gazrat me efekt serrë janë diçka më shumë. Pra, nuk janë vetëm ato që monitoron sistemi sot. Duke qenë se gjeneruesit e këtyre gazrave me efekt serrë janë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, kjo e bën pak më të komplikuar, prandaj edhe u mor iniciativa.

Njëkohësisht, në relacion janë dhënë edhe disa rekomandime të Bashkimit European. Në progres-raportet që ne kemi bërë, gjithmonë ka pasur rekomandime nga Bashkimi European që Shqipëria të marrë iniciativën për hartimin e një ligji, për hartimin e një strategjie kombëtare, për ndryshimet klimatike. Përveç ligjit, ne kemi hartuar edhe strategjinë kombëtare për ndryshimet klimatike, e cila është në proces dhe do të miratohet së shpejti. Në këtë dokument strategjik janë parashikuar objektivat kombëtare dhe masat që do të marrë në vazhdimësi.

Kështu që, është model i Bashkimit European, sepse Marrëveshja e fundit e Parisit ishte marrëveshje globale, por më shumë me ndikim european. Shqipëria e ka ratifikuar Marrëveshjen e Parisit dhe është bërë pjesë edhe e nismave europiane. Por ne, duke qenë vend në proces për anëtarësim në Bashkimin European, natyrisht, kemi marrë dhe kemi detyrimet tona edhe në kuadër të Bashkimit European. Ligji është standard i Bashkimit European, por është edhe ligj standard i Konventës së Ndryshimeve Klimatike, që ua rekomandojnë vendeve anëtare për ta integruar në legjislacionin e tyre kombëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Po.

Ornela Çuçi - Në fakt, ne kemi qenë në muajin maj në procesin e *Screening*-ut në Bashkimin European, ku të gjithë ekspertët e Bashkimit European për çështje të ndryshme na kanë shpjeguar se çfarë do të duhet dhe nuk do të duhet të kemi në këtë fazë të parë për aderimin në Bashkimin European. Direktiva e ndryshimeve klimatike në Bashkimin European është direktiva nr. 87/2003, e cila përcakton një skemë shumë të qartë për tregtimin e lejeve për shkarkim të gazrave serrë brenda komunitetit. Amendamentet e saj janë transpozuar, në fakt, në këtë ligj vetëm për monitorimin dhe raportimin. Nuk kemi shkuar më tej, sepse ne kërkojmë fillimisht të ngremë një sistem të shëndoshë të të gjithë kësaj, mbështetur në ligjet për monitorim, raportim, verifikim të shkarkimeve të gazeve serrë, dhe pastaj të shkojmë më tej në të gjithë transpozimin e direktivës. Pra, kemi transpozuar vetëm atë që ne do të mund të bëjmë aktualisht në vitet që vijnë.

Në proceset e *Screening*-ut kemi qenë bashkë me Maqedoninë e Veriut. Proceset e *Screening*-ut i kanë kaluar edhe vendet e rajonit. Në këtë mënyrë kemi parë ku ata kanë çaluar, ndaj “e kemi pjekur në furrë” ligjin për tre vjet, në mënyrë që edhe në të mos transpozohet 100% dhe mot-a-mot ato pjesë të direktivës që duhet të shkarkojmë, por nga ana tjetër duhet të ngelemi aty ku do të mund të ishim më afër implementimit në situatën aktuale në Shqipëri.

Për sa i përket kostos, do të më duhet të pyes, sepse nuk e di këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Dakord. Faleminderit!

Ne mund të kalojmë në miratimin në parim të projektligjit!

Kush është dakord me miratimin në parim të ligjit “Për ndryshimet klimatike”? Kundër dhe abstenim nuk ka. Faleminderit!

Kalojmë në miratimin nën për nën të projektit.

Jemi të detyruar të bëjmë një kalim formal, ku mund të ketë ndërhyrje ose sugjerime nga kolegët, por ndërkohë do të jenë tre komisione të tjerë që do të duhet të japin kontributin e tyre për përmbajtjen e këtij projektligji. Do të jetë Komisioni i Integritetit, i cili do të shikojë nivelin e përputhjes me legjislacionin ndërkombëtar, do të jetë Komisioni i Ligjeve, si dhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, që është edhe komisioni përgjegjës për këtë projekt.

Kështu që, u sugjeroj kolegëve që, në rast se kanë ndonjë ndërhyrje, e mira është që ato të bëhen nga aspekti i përgjegjësisë që ne mbulojmë si komision.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Përkufizimet.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Politikat kombëtare për ndryshimet klimatike, për objektivat dhe parimet.

Besoj se këto u shprehën qartë.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6.

Integrimi i ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7.

Kontributi kombëtar i përcaktuar.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8.

Monitorimi, raportimi dhe verifikimi i shkarkimeve të gazeve të efekteve serrë nga instalime.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9

Kriteret për përfshirjen e shkarkimeve të gazrave serrë në lejen e mjedisit.

Pro?

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Në fakt, nuk është thelbësore, por thjesht për t’u sqaruar.

Kudo përmendet “me propozimin e ministrit” dhe diku, për shembull, te një nen tjetër, thuhet “ministri për Energjinë dhe Ministri”. Besoj se ju nënkuptoni që është ministri i linjës, por duhet theksuar. Për shembull, te neni 15 thuhet, “propozim i ministrit përgjegjës për Energjinë dhe të ministrit”, që është ministri ... E keni te përkufizimet.

Ermonela Felaj – Dëgjoni një sqarim në lidhje me atë që thatë. Apo jeni dakord me sugjerimin e zonjës Gjebrea?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Kam përshtypjen se zonja Gjebrea kërkon t’i përmbahet të njëjtës shprehje. Nëse ministri është i përkufizuar te përkufizimet, do të thotë që të përdoret fjala ‘ministër’ në çdo rast që ju e përmendi dhe jo duke i shtuar edhe “ministër” i kësaj fushe.

Elona Gjebrea - Këtu thuhet ministri përgjegjës për Mjedisin.

Ermonela Felaj – Zakonisht ashtu bëhet, sepse fusha e përgjegjësisë është një gjë që ndonjëherë ndryshon, por varet edhe nga mënyra si konfigurohet ministria.

Miratohet neni 9. Nuk kemi vërejtje.

Neni 10

Aplikimi për leje mjedisi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14

Sektori i energjisë.

Këtu jepen disa prej institucioneve qendrore që bëhen përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15.

Shkarkimet nga lëndët djegëse.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Te neni 15 thuhet që furnizuesit e lëndëve djegëse, përfshirë biokarburantet, monitorojnë dhe raportojnë shkarkimet e gazrave. Mundet që furnizuesi që raporton, edhe të raportojë të njëjtën gjë? Nuk e kuptoj këtë gjë.

Ermonela Felaj – Po, zoti Abeshi.

Pëllumb Abeshi – Ka një metodologji që vetëm të jepet e dhënë sasia e saktë e karburantit të përdorur të shpenzuar për transportin publik dhe pastaj ka metodologji të përlllogaritjes së shkarkimeve të gazrave serrë, mbi bazën e përmbajtjes së këtyre karburanteve.

Elona Gjebrea – Monitorimin nuk e bëjnë struktura jashtë furnitorëve? Këta edhe bëjnë raportimin, edhe monitorojnë vetë, ndërkohë, mund të ketë probleme dhe s'mund të monitorojë vet punën e tij. Kështu e kuptoj unë.

Pëllumb Abeshi – Në praktikën e sotme kemi vetëmonitorimin, ku subjekti, në bazë të lejes së mjedisit që ka marrë, detyrohet të bëjë vetëmonitorimin duke kontraktuar dhe të raportojë sipas detyrimeve që lidh në kontratë. Është Sistemi Kombëtar i Monitorimit, që nuk është përgjegjësi e subjektit, por është përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit që kemi sot, përgjegjës për të kryer këtë sistem të monitorimit kombëtar.

Natyrisht, sistemi kombëtar bëhet në mënyrë të kontraktuar me institucionet përkatëse, kurse këtu bëhet fjalë për detyrimet që ka vetë subjekti që zhvillon veprimtarinë ekonomike dhe që emeton gazrave me efekt serrë.

Ornela Çuçi - Në fjalinë e fundit të pikës 1, të nenit 15, specifikohet: “Raportet e shkarkimeve janë subjekt i verifikimit përpara dorëzimit të tyre në AKM”. Pika e dytë tregon se rregullat e detajuara që lidhen me mekanizmin e monitorimit, reduktimit dhe shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga lëndët djegëse të lëngëta, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për Energjinë dhe ministrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Pra, ka një monitorim të ndërsjellë; një që do ta bëjnë subjektet dhe një që do të bëhet nëpërmjet sistemit kombëtar ...

Subjekti vetë. Furnizuesit që kontraktojnë shërbimin e të tretëve.

Pëllumb Abeshi - Edhe subjekti që është subjekt i vetëmonitorimit, nuk e kryen vetë, por e nënkontraktton me subjekte të licencuara, të akredituara për të kryer monitorimin ...

Ermonela Felaj – Po, e kontraktton shërbimin nga të tretët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ornela Çuçi – Bazuar në ligjin për lejet e mjedisit aktualisht në Republikën e Shqipërisë, çdo subjekt është i detyruar të bëjë vetëmonitorimin çdo 6 muaj dhe ta raportojë pranë AKM-së dhe mandej AKM-ja verifikon këtë vetëraportim. E njëjta gjë ndodh edhe në këtë ligj për gazet me efekt serrë, që është një nga specifikat e monitorimeve.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se kolegët i morën përgjigjet.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18. Ndryshimi dhe përdorimi i tokës dhe pyjet.

Në fakt, po marr shkas t’u bëj një pyetje përfaqësuesve të Drejtorisë Juridike.

Nëse një sipërfaqe toke e konsideruar truall është shpallur formalisht nga Ministria e Mjedisit si *hot spot*, si një zonë e papërdorshme për një qëllim tjetër për shkak të ndotjes së lartë që ka, kush e ka detyrimin të bëjë ndryshimin e zërit kadastral të tokës? A ka detyrim ministria juaj të përfshijë struktura që ta bëjnë këtë, në mënyrë që të vihen në veprim plane të ndryshme, të cilat ndikojnë në pastrimin e zonës dhe përdorimin e saj për arsye të tjera, që nuk lidhen me bujqësinë ose me ndërtimin, por që janë projekte që ndikojnë në pastrimin e saj?

Pëllumb Abeshi – Sipas fushës së përgjegjësisë, për shembull për ndryshimin kadastral të tokës bujqësore është Ministria e Bujqësisë.

Ermonela Felaj – Unë po jua bëj pyetjen konkrete, që t'ju sjell në temë. Përpara disa vjetëve qeveria shqiptare ka paguar një studim për zonën naftëmbajtëse të Kuçovës (aty ka një vend që quhet kodra e përpunimit të naftës), e cila dikur përmbante gropat e serës dhe, sipas studimit, ajo është një zonë e ndotur, që kërkon një shumë të konsiderueshme parash për t'u rehabilituar dhe për t'u pastruar. Nuk mund të përdoret as për arsye bujqësore, as për ndërtim e ku di unë së çfarë, sepse Ministria e Mjedisit ka marrë një vendim duke e shpallur *hot spot*. Ndërkohë në këtë qytet ka kërkesa për të vendosur panele diellore dhe për të bërë njëkohësisht rehabilitimin e zonës. Që të përdoret kjo tokë kush duhet ta bëjë ndryshimin, sepse ti nuk mund ta përdorësh si truall atë? Kush e ka detyrimin për ta bërë? A keni detyrim ju si Ministri e Mjedisit t'u kërkonit enteve përkatëse që të ndryshojë kategorizimi i tokës, apo ju nuk jeni përballur me këtë problem?

Pëllumb Abeshi – Jo, Ministria e Mjedisit nuk ka përgjegjësi as për ndryshimin e kategorisë së tokës e as për ndryshimin kadastral të saj.

Ermonela Felaj – Jo se e bëni ju ndryshimin, se nuk jeni ministria përgjegjëse për këtë gjë, por kur ka një projekt që lidhet drejtpërdrejt me mjedisin, me ndotjen etj, pra, diçka që hyn në fushën e përgjegjësisë suaj, a jeni të legjitimuar të merrni iniciativën që, për këto sipërfaqe toke të shpallura si *hot spot*-e nga ju, të ndryshojë edhe kategorizimi në mënyrë që t'u hapet rrugë zbatimit të projekteve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, do ta marr këtë përgjegjësi si deputete e asaj zone që t'ju pyes nëse mund të avancojmë diçka për pastrimin e një prej *hot spot*-eve më të spikatura në të gjithë Shqipërinë.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19. Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit.

A ka ndonjë sugjerim nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21.

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Raportimet përkundrejt konventës.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Kuadri institucional dhe koordinimi ndërministror.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24. Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i 5-të. Ngritja e kapaciteteve, edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut.

Besoj se është pjesa që detyron periudhën 6 muaj për t'u njohur me projektligjin, pastaj për të përgatitur të gjithë arkitekturën që e bën të mundur zbatimin.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26.

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Informacioni dhe ndërgjegjësimi publik.

Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28. Pjesëmarrja publike.

Ky nen është i qartë pasi detyron Ministrinë që në përgatitjen e të gjithë akteve ligjore ose nënligjore të përfshihen të gjithë të interesuarit, duke filluar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Kush është dakord me nenin 28? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29. Nxitja e investimeve miqësore ndaj mjedisit dhe klimës.

Ndoshta pyetja ime lidhej edhe me këtë detyrim.

Kush është dakord me nenin 29? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 30. Transferimi i teknologjive me pak karbon.

Kush është dakord me nenin 30? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31. Përfshirja e sektorit privat.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Unë nuk jam juriste, por mënyra e formulimit të një neni duhet thënë vetëm “nxitja e sektorit privat” më duket shumë e përgjithshme. Ndoshta mund të përfshihet në një nen tjetër në të gjithë përfshirjen që ju keni me struktura të tjera jashtë shtetit. Ky është një sugjerim. Nuk kam parë ndonjëherë këtë lloj formulimi në një nen.

Ermonela Felaj – Mirë, nenin 31 do ta diskutojmë në komisionin përkatës.

Kalojmë te neni 32.

Kush është dakord me nenin 32? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33.

Kush është dakord me nenin 33? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34.

A ka ndonjë vërejtje, ndërhyrje, apo sqarim nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Domethënë vlerat e gjobave duken shumë të larta dhe në fakt, nuk e di se si do ta gjejmë ekuilibrin mes gjobave administrative dhe penale, sepse janë me të vogla gjobat penale në raport me ato administrative. Ndërkohë që një gjobë penale është dënim i vërtetë dhe të bën të të nxihet ajo dëshmia e penalitetit, gjoba administrative nuk është se ndikon në këtë pjesë. Megjithatë dëmet janë të larta, nevoja për t’u mbrojtur nga këto ndryshim është po ashtu e lartë, por ndoshta ne mund t’u rrimë këtyre parashikimeve që keni bërë. Nëse zonja Dhima bashkohet me mua le t’ua lëmë kolegëve të tjerë për të parë se çfarë vlerësimi kanë për këtë.

Po, mund ta bëni një shpjegim.

Enerieta Tarelli – Neni për kundërvajtjet administrative është në përputhje me ligjin “Për lejet e mjedisit”. Nëse i referohemi nenit 29 të ligjit nr. 10448 të miratuar në vitin 2011

janë parashikuar këto vlera gjombash, madje përqindja për ditë është 10% më e madhe. Kështu që mendojmë se, duke qenë se dëmi është goxha i madh, duhet të jetë në harmoni me kuadrin ligjor në fuqi, prandaj është vendosur ky parashikim.

Ermonela Felaj – Kam edhe diçka për pikën 4 të këtij neni. Ju thoni që gjoba paguhet brenda një periudhe prej 10 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj. Do të ishte parashikim i duhur që ta bënim nga marrja njoftim, se janë dy afate që mund të fillojnë në kohë të ndryshme.

Kush është dakord me nenin 34, me sugjerimin e bërë në pikën 4?

Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 35. Menaxhimi i informacionit.

A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord me këtë nen?

Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 36.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 37, ku parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore dhe afati kohor brenda së cilit ato do të duhet të...

Kush është dakord me nenin 37? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Më duket se kolegët kanë dyshime se afati është shumë i gjatë, por ju na e thatë pse.

Neni 38 ka të bëjë me aktet nënligjore që mbeten në fuqi.

Unë kam një pyetje. Duke parë nenin 38 në raport me nenin 39 (thjesht për teknikë), pse duhet t'i citoni vendimet që shfuqizohen dhe ato që nuk shfuqizohen? Duke cituar vendimet që shfuqizohen indirekt kuptohet që të tjerat janë ende në fuqi. Pse e keni këtë nevojë? Keni merakun se institucionet do të konfondohen dhe doni që kjo të jetë në ligj që ata të dinë kuadrin ligjor? Me thënë të drejtën e kemi pak problem te kjo pjesa e legjislacionit.

Pëllumb Abeshi – Qëllimi ka qenë që zbatimi dhe hyrja në fuqi e ligjit të mos shkaktojnë konfuzion te zbatuesit e tij, pra për të qenë më i qartë.

Ermonela Felaj – Unë do të sugjeroja që nenet 38 dhe 39 t'i shikonim në një nen të vetëm nëse është e mundur dhe të mos bënim dy nene të veçanta.

Po, zonja Tarelli.

Enerieta Tarelli – Neni 39 parashikon shfuqizimin dhe ky lidhet automatikisht me hyrjen ne fuqi të ligjit pas 6 muajve, kurse neni 38 lidhet me aktet tranzitore, pra që do të kenë fuqi deri sa të miratohen aktet e tjera. Prandaj është parashikuar diferencimi i të dyja akteve.

Ermonela Felaj – Pra e keni të nevojshme.

Kush është dakord me nenin 38? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 39? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40. Hyrja ne fuqi.

Kush është dakord që ligji të hyjë në fuqi 6 muaj pas botimit ne Fletoren Zyrtare? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi më projektligjin “Për ndryshimet klimatike”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit kolegëve të Ministrisë së Mjedisit!

I uroj punë të mbarë deputetëve!

U kujtoj deputetëve që janë anëtarë të Nënkomisionit të Vetingut se ditën e premte do të kemi një mbledhje për nënkomisionin, orën do ta caktojmë pasi të kemi konfirmimin e Komisionit të Vetingut të Policisë së Shtetit.

Mbyllet mbledhja.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA